

1 E premte, 29 nëntor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Urdhër për zhdëmtim]

4 [Pjetër Shala nuk është i pranishëm]

5 --- Seanca fillon në orën 11.00

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Mirëmëngjesi, të gjithëve. Mirë se erdhët në sallën e gjyqit.

8 Sekretare e seancës, paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar  
10 Gjykatës. Kjo është lënda KSC-BC-2020-04, Prokurori i  
11 Specializuar kundër Pjetër Shalës.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Faleminderit.

14 Pikësëpari, do ju lutesha që të prezantohen palët. Po  
15 fillojmë me Mbrojtësin e Viktimave. Ju lutem na thoni kush  
16 është i pranishëm në ekipin tuaj.

17 Z. LAWS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Unë jam Simon Laws,  
18 Avokati i Viktimave në këtë lëndë gjyqësore, bashkë me  
19 bashkëmbrojtësen Maria Radziejowska.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

21 I drejtohem Mbrojtjes tani. Avokat, kush është i  
22 pranishëm për ju?

23 Z. GILISSEN: [Përkthim]. Mirëmëngjesi. Unë jam z.  
24 Gilissen. Z. Shala, nuk është i pranishëm sikurse jeni në  
25 dijeni. Këtu është z. Aouini, bashkëmbrojtës dhe znj.

1 Petrovica, menaxhere e lëndës. Faleminderit.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit.

4 Për procesverbal, z. Shala nuk është i pranishëm  
5 fizikisht në sallën e gjyqit.

6 Z. Prokuror, fjala është për ju.

7 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar  
8 Gjykatës. Nga Prokuroria janë të pranishëm Prokurori Ward  
9 Ferdinandusse dhe Filippo De Minicis.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani  
11 i drejtohem Zyrës Administrative.

12 ADMINISTRATORJA: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Jam Fidelma  
13 Donlon, administratore, bashkë me mua këtu është Jonas  
14 Nilsson, zëvendësadministratori dhe Tadeja Novinc shefe e  
15 Zyrës për Mbrojtjen e Viktimave.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për  
17 procesverbal, ne jemi Trupi Gjygues 1 ku është Gjykatësi  
18 Dekkers, Gjykatësi Bitti, Gjykatësi Mikula dhe unë, Gjykatësj  
19 Veldt-Foglia si Kryegjykatëse.

20 Trupi Gjygues 1 do të shqiptojë sot Urdhrin për Zhdëmtim  
21 në lëndën Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës. Një  
22 përmbledhje e këtij Urdhri për Zhdëmtim do të shqiptohet në  
23 seancë publike. Gjykatësi Bitti ka qenë relator për këtë  
24 Urdhër për Zhdëmtim.

25 Gjatë kohës që do të lexoj përmbledhjen e gjetjeve

1 kryesore që ka bërë Trupi Gjykses, dëshiroj të theksoj që kjo  
2 përmbledhje nuk është pjesë e urdhrin zhdëmtues i cili është  
3 versioni i vetëm autoritativ i vendimit përfundimtar të Trupit  
4 Gjykses. Përmbledhja jo-autoritative do të gjendet në faqen e  
5 internetit të Trupit Gjykses.

6 Fillimisht, Trupi Gjykses vëren se ky është Urdhri i dytë  
7 për Zhdëmtim që lëshojnë Dhomat e Specializuara. Trupi Gjykses  
8 shfrytëzon këtë mundësi për të ritheksuar se zhdëmtimet janë  
9 një pjesë përbërëse e proceseve gjyqësore përpara Dhomave të  
10 Specializuara. janë thelbësore për t'ju dhënë drejtësi  
11 viktimave të shkeljeve të rënda të Së drejtave të njeriut dhe  
12 të drejtës ndërkombëtare humanitare.

13 Ky Urdhër për Zhdëmtim buron nga shpallja e fajësisë së  
14 z. Pjetër Shala më 16 korrik 2024. Ritheksoj në këtë drejtim  
15 se z. Shala u shpall fajtor nga ky Trup Gjykses lidhur me tri  
16 akuza për krime lufte - konkretisht, ndalim arbitrar, torturë  
17 dhe vrasje e paligjshme - që i kreu si pjesë e ndërmarrjes  
18 kriminale të përbashkët afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5  
19 qershorit 1999 në fabrikën e metalit në Kukës, që tani e  
20 paskëtaj do t'i referohemi si FMK, një fabrikë e dikurshme për  
21 përpunimin e metalit në Kukës, Shqipëri. Z. Shala u dënua me  
22 18 vjet burgim, duke Iu llogaritur koha e mbajtjes në  
23 paraburgim që nga marsi 2021.

24 Rikujtoj se viktimat pjesëmarrëse në procesin gjyqësor në  
25 këtë lëndë gjyqësore përfituan nga masat mbrojtëse:

1 konkretisht, emrat dhe të dhënat e tyre identifikuese nuk ju  
2 shfaqën publikut. Rrjedhimisht, gjatë këtij gjykimi gjatë  
3 kësaj seance, kur t'u referohem viktimave, do të përdorë kodet  
4 që ju ishin caktuar këtyre viktimave. Trupi Gjykses ka parë me  
5 kujdes të gjitha informacionet shtesë që mund të nxirren për  
6 publikun duke ekuilibruar kështu nevojën për të mbrojtur  
7 viktimat me parimin e proceseve gjyqësore transparente.

8 Tani do të filloj me përmbledhjen e Urdhrit për Zhdëmtim.  
9 Fillimisht do të jap një historik të shkurtër të procesit  
10 gjyqësor.

11 Më 9 shkurt 2023, Trupi Gjykses vendosi se procesi për  
12 zhdëmtim do të kryhet njëherazi me procesin penal në çështjen  
13 aktuale dhe, në rast se do të ketë shpallje të fajësisë, nuk  
14 do t'i referonte viktimat për litigim civil në gjykatat e  
15 Kosovës, por do të nxirrte vetë Urdhër për Zhdëmtim.

16 Më 4 mars 2024, Mbrojtësi i Viktimave dorëzoi një kërkesë  
17 për zhdëmtim në emër të tetë viktimave që u pranuan si pjesë e  
18 këtij procesi gjyqësor.

19 Për të dhënë një panoramë të plotë të ligjeve dhe  
20 parimeve përkatëse, unë do t'i referohem versionit publik të  
21 Urdhrit për Zhdëmtim. Për qëllim të kësaj përmbledhjeje, dua  
22 të theksoj si në vijim.

23 Trupi Gjykses thekson se qëllimi i zhdëmtimit në Dhomat e  
24 Specializuara është jo vetëm ndëshkimi i personit të shpallur  
25 fajtor sikurse parashikohet në nenin 44(6) të ligjit, por edhe

1 njohja dhe zhdëmtimi, aq sa është e mundur, i dëmit që i është  
2 shkaktuar viktimave.

3 Për rrjedhojë, viktimat duhet të marrin zhdëmtim të  
4 arsyeshëm, të përshtatshëm dhe të shpejtë.

5 Sa u përket parimeve të zbatueshme lidhur me  
6 përgjegjësinë e personit të shpallur fajtor për zhdëmtim,  
7 Trupi Gjykses konstaton se Urdhri për Zhdëmtim nuk mund të  
8 dalë jashtë kuadrit të veprave penale për të cilat personi u  
9 shpall fajtor dhe duhet të lëshohet në të gjitha rrethanat  
10 kundër personit të shpallur fajtor.

11 Përgjegjësia e personave apo organizatave të tjera ose  
12 përgjegjësia e shtetit nuk është relevante për përcaktimin e  
13 përgjegjësisë së personit të shpallur fajtor lidhur me  
14 zhdëmtimin.

15 Po kështu, mungesa e mjeteve financiare të personit të  
16 shpallur fajtor nuk është relevante për marrjen e këtij  
17 vendimi.

18 Tani do të trajtoj shkurtimisht qasjen e Trupit Gjykses  
19 sa i takon vlerësimin të provave që kanë paraqitur viktimat  
20 për qëllim zhdëmtimi.

21 Pikësëpari, Trupi Gjykses u mbështet në konstatimet  
22 faktike dhe ligjore të bëra në aktgjykim të cilat çuan në  
23 shpalljen e fajësisë dhe dënimin e z. Shala.

24 Trupi Gjykses gjithashtu shqyrtoi kërkesën e Mbrojtësit  
25 të Viktimave për zhdëmtim, deklaratën për pasojat dhe

1 aktekspertizat e dorëzuara nga Mbrojtësi i Viktimave dhe  
2 Mbrojtja në lidhje me dëmin e pësuar nga viktimat.

3 Përpara se të kaloj te Urdhri për Zhdëmtim kundër z.  
4 Shala, dua të bëjë një përmbledhje të konstatimeve të Trupit  
5 Gjykues sa i takon shkallës dhe përmasës së dëmit që kanë  
6 pësuar viktimat pjesëmarrëse në këtë çështje gjyqësore në  
7 përputhje me nenin 22(7) të ligjit.

8 Do të filloj tani me parashtrimet e Mbrojtësit të  
9 Viktimave dhe të Mbrojtjes.

10 Mbrojtësi i Viktimave pretendon se Viktima 01 pësoi dëm  
11 fizik, mendor dhe material si pasojë e krimeve të luftës dhe  
12 ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme të  
13 kryera nga z. Shala.

14 Ai më tej argumenton se Viktimat 02, 03, 04, 05, 06, 07  
15 dhe 08 kanë pësuar dëm mendor afatgjatë, si dhe dëm material  
16 si pasojë e krimeve të luftës, të arrestimit arbitrar dhe  
17 torturës, të kryera nga z. Shala kundër anëtarit të familjes  
18 së tyre me të cilin kishin marrëdhënie të ngushtë.

19 Në përgjigje, Mbrojtja argumenton se Mbrojtësi i  
20 Viktimave nuk identifikoi shkallën dhe përmasat e dëmit fizik  
21 të pësuar nga Viktima 01, dhe se si dëmi fizik dhe mendor i  
22 pësuar nga Viktima 01 ishte rezultat i drejtpërdrejtë i  
23 krimeve për të cilat z. Shala u shpall fajtor.

24 Sa u përket Viktimave 02 deri në 08, Mbrojtja gjithashtu  
25 argumenton se Mbrojtësi i Viktimave nuk ka vërtetuar

1 standardin e kërkuar në lidhje me dëmin material.

2 Më gjerësisht, Mbrojtja argumenton se dëmi fizik dhe  
3 mendor i pësuar nga viktimat nuk u shkaktua drejtpërdrejt nga  
4 krimet për të cilat z. Shala u shpall fajtor, pasi veprimet që  
5 shkaktuan dëmin, nuk u kryen nga z. Shala. Për rrjedhojë,  
6 sipas Mbrojtjes, z. Shala nuk mund të mbahet përgjegjës për  
7 kompensimin e dëmit material që pësuan viktimat. Për këto  
8 arsye, Mbrojtja i kërkon Trupit Gjykses të hedhë poshtë  
9 kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për zhdëmtim dhe të hedhë  
10 poshtë kërkesën e lëshimit të një Urdhri për Zhdëmtim.

11 Tani do të flas për konstatimet e Trupit Gjykses.

12 Shkurtimisht do të jap konstatimin e Trupit Gjykses për  
13 secilën nga Viktimat.

14 Do të fillojmë me Viktimën 01, viktimën e drejtpërdrejtë.

15 Fillimisht, Trupi Gjykses mbështetet në konstatimet e  
16 bëra në aktgjykim të cilat vërtetojnë se Viktima 01 u mbajt në  
17 ndalim arbitrar dhe u torturua në FMK nga z. Shala dhe anëtarë  
18 të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Edhe tani edhe  
19 paskëtaj do t'i referohemi si UÇK, dhe se pësoj dëm fizik,  
20 mendor dhe material si rezultat i kësaj.

21 Sa i përket dëmit fizik që pësoi Viktima 01, Trupi  
22 Gjykses gjykon se kjo viktimë u keqtrajtua rëndë gjatë gjithë  
23 kohës që u mbajt në ndalim. Ai u bë rregullisht objekt i  
24 rrahjes, ngacimit dhe poshtëritit prej anëtarëve të UÇK-së,  
25 përfshirë z. Shala. Ai u mbajt i ndaluar në kushte çnjerëzore

1 dhe poshtëruese. Gjatë kohës që u mbajt në ndalim, Viktima 01  
2 u godit ndër të tjera me shufra metali, shkopinj bejsbolli dhe  
3 gome dhe të paktën në një rast me një armë zjarri. Ai u  
4 keqtrajtua për orë të tëra. Kokën ia kanë mbajtur në ujë disa  
5 herë. Edhe i kanë shkaktuar plagë. Si rezultat i ndalimit, ai  
6 pësoi lëndime të shumta, ndër të tjera dhe në kokë. Edhe sot e  
7 kësaj dite ai ka vraga të dukshme nga keqtrajtimi fizik që  
8 pësoi. Ai vazhdon të ketë dhimbje në brinjë dhe eshtra dhe  
9 vuan nga dhimbje koke.

10 Sa i përket dëmit mendor, Trupi Gjykues mban parasysh se  
11 kur u mbajt i ndaluar në FMK Viktima 01 nuk u informua për  
12 arsye të heqjes së lirisë, nuk e dinte se sa do të zgjaste  
13 ndalimi dhe nuk pati mundësi të kontaktonte me familjen dhe  
14 botën e jashtme. Gjatë mbajtjes në ndalim në FMK, Viktima 01  
15 dëgjoi keqtrajtimin e rëndë të të ndaluarve të tjerë dhe pa  
16 lëndimet që kishin pësuar ata. Kjo i shkaktoi tension tejet të  
17 madh psikologjik.

18 Edhe sot e kësaj dite, Viktima 01 ka simptoma të rënda të  
19 çrregullimit të stresit post-traumatik. Ai ka frikë për  
20 sigurinë e vet dhe të familjes së tij dhe ruhet gjatë gjithë  
21 kohës.

22 Gjithashtu, në lidhje me dëmin mendor që pësoi, Trupi  
23 Gjykues vëren se Viktima 01 u etiketua nga personat që e  
24 mbanin të ndaluar si "bashkëpunëtor" i autoriteteve serbe dhe  
25 "spiun". Viktima 01 përshkroi se u ndje thellësisht i lënduar,



1 konfuz dhe i tradhtuar nga ky stigmatizim.

2 Sa i përket dëmit material që pësoi Viktima 01, Trupi  
3 Gjykues konstaton se simptomat ÇSPT të Viktimës 01 ishin aq të  
4 rënda sa që ia bënë të pamundur të jetonte jetën ashtu si  
5 përpara ngjarjeve, si dhe të fitonte jetesën për vete dhe  
6 familjen. Trupi Gjykues është i bindur se krimet për të cilat  
7 z. Shala u shpall fajtor dhe stigmatizimi shoqëror që  
8 shkaktuan, kontribuuan që Viktima 01 të humbiste mundësi dhe  
9 ta kishte të pamundur të rifitonte pavarësinë e vet financiare  
10 dhe të mbante familjen e tij.

11 Bazuar në sa më lartë, Trupi Gjykues konstaton se Viktima  
12 01 pësoi dëm fizik, mendor dhe material me pasoja afatgjata si  
13 rezultat i krimeve të luftës, të ndalimit arbitrar, torturës  
14 dhe vrasjes së paligjshme, për të cilat z. Shala u shpall  
15 fajtor.

16 Flasim për Viktimat 02 deri në 08.

17 Trupi Gjykues konstaton se Viktimat 02 deri në 08 pësuan  
18 dëm si viktima të tërthorta të krimeve të luftës, të ndalimit  
19 arbitrar dhe të torturës për të cilat z. Shala u shpall fajtor  
20 në lidhje me Dëshmitarin W04733. Viktimat 02 deri 08 ishin  
21 anëtarë familjes së W04733 dhe tani do t'u referohemi e më tej  
22 si viktima të tërthorta.

23 Fillimisht do të paraqes konstatimet që kanë të bëjnë me  
24 W04733 në lidhje me të cilët anëtarë të familjes së tij  
25 pretendojnë se kanë pësuar dëm.

1 Trupi Gjykses rikujton se në aktgjykim konstatoi përtej  
2 dyshimit të arsyeshëm se W04733 u ndalua arbitrarisht dhe u  
3 keqtrajtua në FMK nga anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët z.  
4 Shala. Ashtu si dhe të ndaluarit e tjerë, W04733 u mbajt i  
5 ndaluar në kushte çnjerëzore dhe poshtëruese ndalimi. W04733 u  
6 rrah brutalisht dhe rregullisht, përfshirë edhe nga z. Shala.  
7 Si pasojë e keqtrajtimit, W04733 pësoi një numër lëndimesh dhe  
8 vragash përfshirë një vragë në ballë, shenja djegieje në gjoks  
9 e shpatull, bërryl të lënduar dhe dhëmbë të thyer.

10 Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se ashtu si të  
11 ndaluarit e tjerë W04733 përjetoi atmosferë frike dhe  
12 brutaliteti në FMK. Ai u detyrua të shihte vuajtjet dhe  
13 poshtërimin e të ndaluarve të tjerë, përfshirë edhe nga z.  
14 Shala, ndërsa dhe ai rrihej dhe poshtërohej në praninë e tyre.  
15 Ai u morr në pyetje rregullisht dhe u akuzua se bashkëpunonte  
16 me autoritetet serbe. Kjo pati pasoja të thella dhe afatgjata  
17 në mirëqenien psikologjike të tij. W04733 raportoi se  
18 përjetonte makthe dhe jetonte vazhdimisht me stres. Ai ishte  
19 vazhdimisht i irrituar. Ai gjithashtu ishte i frikësuar dhe  
20 ruhej gjithë kohën, madje kishte frikë të shkonte dhe tek  
21 mjeku, pavarësisht nga lëndimet e rënda që kishte pësuar në  
22 FMK.

23 Trupi Gjykses vëren se pasojat e ndalimit arbitrar dhe  
24 keqtrajtimit të W04733 në shëndetin fizik dhe mendor të tij  
25 patën ndikim rrënues mbi familjen e tij, viktimat e tërthorta.

1           Sa i përket dëmit mendor që pësuan viktimat e tërthorta,  
2   ata e përshkruan frikën dhe ankthin që përjetuan ngaqë nuk e  
3   dinin se ku ishte i afërmi i tyre menjëherë pasi u arrestua.  
4   Ata gjithashtu përshkruan brengosjen që ju shkaktua kur panë  
5   gjendjen fizike dhe mendore të W04733 pas lirimit. Familja  
6   gjithashtu pati vuajtje mendore prej pasojave afatgjata të  
7   ndalimit dhe të keqtrajtimit mbi gjendjen fizike dhe  
8   psikologjike të W04733. Atyre ju desh të mësonin të jetonin me  
9   ndryshimet në personalitetin dhe sjelljen e W04733 si dhe me  
10   format në të cilat shprehej trauma e tij.

11           Tre nga djemtë e W04733 e përshkruan babain e tyre si "i  
12   shkatërrum", "në agresivitet", "jo ashtu si e kam njoft unë ma  
13   herët" dhe "i thyer". Sipas saj, Viktima 03 tregoi se krimet e  
14   kryera kundër W04733 ndikuan "në gjendjen shëndetësore të  
15   gjithë familja kemi pas strese sepse të gjithë kemi pas  
16   trauma, kemi përdorë terapi, medikamente".

17           Së fundi, akuzat që u bënë W04733 anëtarët e UÇK-së  
18   kontribuuan në stigmatizimin e familjes. Për rrjedhojë,  
19   familja nuk ndihej e sigurtë sepse kishin frikë se mund të  
20   pësonin më shumë dëm.

21           Sa i përket dëmit material, Trupi Gjykues rikujton se si  
22   pasojë e ndalimit arbitrar dhe keqtrajtimit në FMK, W04733 nuk  
23   ishte më në gjendje të fitonte jetesën për familjen pasi u  
24   kthye. Si rezultat, familja mbeti pa kontribuuesin kryesor të  
25   të ardhurave.

1 Gjithashtu, Trupi Gjykues vëren se viktimat e tërthorta  
2 patën shpenzime në lidhje me kujdesin mjekësor që iu dha  
3 W04733 për trajtimin e lëndimeve fizike që pësoi në FMK, si  
4 dhe me shëndetin e tij që u përkeqësua gjatë viteve.

5 Së fundi, Trupi Gjykues thekson se, si pasojë e krimeve  
6 të kryera kundër W04733 në FMK dhe stigmës së shkaktuar,  
7 familja jetoi në frikë për sigurinë e anëtarëve të saj dhe për  
8 këtë arsye bëri zgjedhje dhe mori vendime që kufizuan  
9 perspektivat e ardhshme të tyre.

10 Duke u bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues arrin në  
11 përfundimin se Viktima 02 deri në 08 pësuan dëm mendor dhe  
12 material me pasoja afatgjata, si rezultat i krimeve të luftës,  
13 të ndalimit arbitrar dhe torturës, për të cilat z. Shala u  
14 shpall fajtor në lidhje me W04773.

15 Kjo përmbyll konstatimet e Trupit Gjykues sa i takon  
16 shkallës dhe përmasës së dëmit që pësuan viktimat dhe tani do  
17 të flas për Urdhrin për Zhdëmtim kundër z. Shala.

18 Ky Urdhër për Zhdëmtim jepet drejtpërdrejt kundër z.  
19 Shala. Përfituesit e zhdëmtimit janë Viktimat 01 deri në 08.

20 Sa i takon llojeve dhe modaliteteve të zhdëmtimit, Trupi  
21 Gjykues vendos si në vijim.

22 Trupi Gjykues vë në dukje se shpallja e fajësisë dhe  
23 dënimi i shqiptuar në aktgjykim tashmë përbëjnë një lloj mjeti  
24 juridik në formën e njohjes për tetë viktimat. Zhdëmtimi u jep  
25 gjithashtu viktimave mundësinë për të kërkuar dhe marrë

1 drejtësi për krimet kundër tyre ose një anëtar i të familjes së  
2 tyre të kryera më se dy dekada më parë. Së fundi, ai  
3 kontribuon në të drejtën e viktimave, familjeve të tyre dhe të  
4 komunitetit të tyre për të pasur qasje në të vërtetën.

5 Bazuar në arsyet e përcaktuara në Urdhrin për Zhdëmtim,  
6 Trupi Gjykses gjykon se kompensimi për secilën nga tetë  
7 viktimat është lloji dhe modaliteti më i përshtatshëm i  
8 zhdëmtimit në këtë çështje gjyqësore. Sipas Trupit Gjykses  
9 kompensimi do të mundësojë një farë lehtësimi financiar për  
10 viktimat.

11 Tani do të trajtoj shkallën e përgjegjësisë së z. shala  
12 për zhdëmtimet. Do të filloj pikësëpari me kërkesën e  
13 Mbrojtësit të Viktimave.

14 Mbrojtësi i Viktimave kërkon në lidhje me Viktimën 01,  
15 10,000 euro për dëm fizik, 30,000 euro për dëm mendor dhe  
16 60,000 euro për dëm material.

17 Në lidhje me Viktimën 03, Mbrojtësi i Viktimave kërkon  
18 10,000 euro për dëm mendor.

19 Në lidhje me Viktimat 02, 04, 05, 06, 07 dhe 08,  
20 Mbrojtësi i Viktimave kërkon 8000 euro për person për dëm  
21 mendor.

22 Së fundi, Mbrojtësi i Viktimave kërkon që një shumë e  
23 gjithsejtë prej 50,000 euro t'u akordohet viktimave të  
24 tërthorta 02, 03, 04, 05, 06, 07 dhe 08 për dëm material.

25 Tani më lejoni që të vazhdoj më tej me përcaktimin e

1 përgjegjësisë së z. Shala sa i takon zhdëmtimeve.

2 Së pari, z. Shala ka përgjegjësi për kompensimin e dëmit  
3 që u shkaktua të gjitha viktimave të drejtpërdrejta dhe të  
4 tërthorta për të cilat është shpallur fajtor. Kjo është  
5 pavarësisht nga forma e përgjegjësisë së përgjegjësisë penale  
6 ku u mbështet shpallja e fajësisë, dhe pavarësisht nëse edhe  
7 persona të tjerë mund të kenë kontribuar për shkaktimin e  
8 dëmit.

9 Së dyti, Trupi Gjykses duhet të përcaktojë shumën për  
10 secilin lloj të dëmit si edhe shumën e gjithsejtë të  
11 përgjegjësisë financiare të z. Shala që e gjykon të arsyeshme  
12 në përputhje me nenin 22(3) i ligjit.

13 Krahas kësaj në përcaktimin e shumës së përgjegjësisë  
14 financiare të z. Shala, Trupi Gjykses merr parasysh shkallën  
15 dhe përmasat e dënimit që pësuat tetë viktimat dhe kërkesën e  
16 Mbrojtësit të Viktimave për zhdëmtim. Gjithashtu, Trupi  
17 Gjykses merr parasysh legjislacionin përkatës të Kosovës. Ky  
18 legjislacion përcakton të drejtat dhe përfitimet që akordohen  
19 për kategori të ndryshme personash të prekur nga konflikti i  
20 armatosur në Kosovë në vitet 1998 dhe 1999. Në këto kategori  
21 përfshihen veteranët dhe civilët e dëmtuar gjatë konfliktit të  
22 armatosur, ata që morën pjesë në luftë dhe familjarët e  
23 anëtarëve të UÇK-së dhe të civilëve të vdekur ose të zhdukur.  
24 Trupi Gjykses e konsideron këtë legjislacion si pikë reference  
25 për përcaktimin e zhdëmtimit që e gjykon të arsyeshëm në

1 kontekstin e Kosovës.

2 Trupi Gjykues gjithashtu vë në dukje udhëzuesin për  
3 caktimin e kriterëve orientuese dhe lartësisë së shpërblimit  
4 të drejtë në të holla të dëmit jo material të Kosovës, të  
5 cilin më poshtë do ta përmendim si Udhëzuesi i Kosovës, të  
6 cilit i referohet Mbrojtësi i Viktimave dhe Mbrojtja. Trupi  
7 Gjykues thekson se Udhëzuesi i Kosovës përmban udhëzime lidhur  
8 me paditë civile në gjykatat e Kosovës dhe si të tilla ato nuk  
9 zbatohen drejtpërdrejt në proceset për zhdëmtim që kanë  
10 lidhje me çështje gjyqësore për krime lufte, krime kundër  
11 njerëzimit në Dhomat e Specializuara. Rrjedhimisht, Trupi  
12 Gjykues gjykon se ato janë relevante vetëm në lidhje me  
13 vlerësimet e dobishme të shumave monetare për dëmin e pësuar  
14 në kontekstin ekonomik aktual në Kosovë.

15 Trupi Gjykues gjithashtu merr parasysh aktekspertizat e  
16 dorëzuara nga Mbrojtësi i Viktimave dhe Mbrojtja në lidhje me  
17 dëmin material. Përkatësisht aktekspertiza e Mbrojtësit të  
18 Viktimave dhe aktekspertiza e Mbrojtjes.

19 Trupi Gjykues vë në dukje se aktekspertiza e paraqitur  
20 nga Mbrojtësi i Viktimave bën vlerësimin e dëmit material të  
21 pësuar nga Viktima 01 dhe viktimat e tërthorta 02 deri në 08  
22 si rezultat i krimeve të kryera nga z. Shala, përkatësisht  
23 kundër Viktimës 01 dhe W04733. Këto vlerësime tregojnë  
24 përmasat e dëmit material individual të pësuar nga viktimat,  
25 sikurse do të ishte bërë në procese të zakonshme lidhur me

1 dëme apo kompensime. Gjithashtu ato i tejkalojnë ndjeshëm  
2 zhdëmtimet individuale të kërkuara nga Mbrojtësi i Viktimave.  
3 Trupi Gjykses konstaton se, duke qenë se shifrat në këtë  
4 raport janë vetëm sugjeruese, ai mund të marrë parasysh, por  
5 ato nuk kanë fuqi detyruese mbi Trupi Gjykses për përcaktimin  
6 e zhdëmtimit.

7 Trupi Gjykses nuk mbështetet në vlerësimet e dhëna në  
8 aktekspertizën e paraqitur nga Mbrojtja për shkak se ajo ka  
9 një numër mangësish të rëndësishme që ndikojnë në kuadrin dhe  
10 vlefshmërinë e konstatimeve të bëra në të.

11 Së fundi, duke pasur parasysh konstatimet e  
12 lartpërmendura, Trupi Gjykses gjykon se shumt e kërkuara nga  
13 Mbrojtësi i Viktimave pasqyrojnë shkallën dhe përmasat e dëmit  
14 të pësuar nga tetë viktimat dhe janë të arsyeshme sikurse  
15 parashikohet në nenin 22(3) i ligjit.

16 Bazuar në të gjitha sa u tha më sipër, duke mbajtur  
17 parasysh shkallën dhe përmasat e dëmit të pësuar nga viktimat  
18 e drejtpërdrejta dhe të tërthorta, dhe duke vendosur për  
19 aspektet e paqarta në favor të personit të shpallur fajtor,  
20 Trupi Gjykses cakton shumën e gjithsejtë të zhdëmtimit të z.  
21 Shala ka përgjegjësi të paguajë në 208,000 euro.

22 Rrjedhimisht z. Shala urdhërohet t'u paguajë si kompensim  
23 për dëmin e shkaktuar:

24 100,000 euro Viktimës 01,

25 10,000 euro Viktimës 03,



1 8000 euro për person Viktimave 02, 04, 05, 06, 07 dhe 08  
2 dhe

3 50,000 euro bashkërisht Viktimave 02, 03, 04, 05, 06, 07  
4 dhe 08.

5 Kjo përfundon vendimin e Trupit Gjykues lidhur me  
6 detyrimin financiar të z. Shala për zhdëmtim.

7 Pjesa e fundit e Urdhrit për Zhdëmtim ka të bëjë me  
8 vënien në jetë dhe zbatimin.

9 Do fillojmë pikësëpari me monitorimin dhe mbikëqyrjen.  
10 Trupi Gjykues vëren se juridiksioni i tij në këtë çështje  
11 gjyqësore përfundon me nxjerrjen e Urdhrit për Zhdëmtim.  
12 Rrjedhimisht, Trupi Gjykues fton Kryetarin e Dhomave të  
13 Specializuara të caktojë një Gjykatës të Vetëm për monitorimin  
14 dhe mbikëqyrjen e vënies në jetë dhe zbatimit të këtij Urdhri  
15 për Zhdëmtim.

16 Tani do flasim për financimin e Urdhrit për Zhdëmtim. Së  
17 pari, nga personi i shpallur fajtor.

18 Sa i përket zbatimit të Urdhrit për Zhdëmtim, Trupi  
19 Gjykues rikujton se përgjegjësinë për pagimin e kompensimit  
20 për viktimat të caktuara nga ky Trup Gjykues e mban  
21 ekskluzivisht z. Shala. Megjithatë, Trupi Gjykues thekson se  
22 në kohën e lëshimit të Urdhrit për Zhdëmtim, Trupi Gjykues nuk  
23 ka asnjë të dhënë nëse z. Shala është në gjendje ta paguajë  
24 plotësisht zhdëmtimin.

25 Në këto rrethana, Trupi Gjykues diskuton se cilët aktorë

1 të tjerë mund të përfshihen në zbatimin e Urdhrit për  
2 Zhdëmtim.

3 Nga Kosova. Trupi Gjykses rikujton se në kontekstin e  
4 procesit Mustafa, Ministria e Drejtësisë e Kosovës e informoi  
5 Trupin Gjykses se viktimave të krimeve të përfshira në  
6 juridiksionin e Dhomave të Specializuara mund t'u akordohet  
7 kompensim ose dëmshpërblim nga programi për kompensimin e  
8 viktimave të krimit i krijuar në bazë të ligjit për  
9 Kompensimin e Viktimave të Krimit. Ky program kompensimi mund  
10 të aktivizohet kur është përcaktuar se personi i shpallur  
11 fajtor nuk është në gjendje të paguajë kompensimin, qoftë  
12 plotësisht apo pjesërisht.

13 Për të ruajtur anonimitetin e tetë viktimave që kërkojnë  
14 zhdëmtim në këtë proces gjyqësor në Dhomat e Specializuara dhe  
15 për të garantuar Mbrojtjen e tyre, Trupi Gjykses urdhëron  
16 Administratoren në koordinim me Mbrojtësin e Viktimave që të  
17 kërkojnë kompensim prej Programit për Kompensimin e Viktimave  
18 të Krimeve në emër të tetë viktimave. Trupi Gjykses mban  
19 parasysh se në rast nevoja Gjykatësi i Vetëm i ngarkuar me  
20 monitorimin dhe mbikëqyrjes e vënies në jetë dhe zbatimin të  
21 Urdhrit për Zhdëmtim mund të konfirmojë se tetë viktimat në  
22 emër të të cilave Administratorja apo Mbrojtësi i Viktimave  
23 mund të paraqesin kërkesë Komisionit për Kompensimin e  
24 Viktimave të Krimit, janë me të vërtetë viktimat të cilëve u  
25 është akorduar kompensim për Urdhrin për Zhdëmtim.

1 Gjithashtu, Trupi Gjykues vëren se duhet të parashikohen  
2 mënyra të tjera për zbatimin e plotë të Urdhrit për Zhdëmtim.

3 Duke mbajtur parasysh shumën maksimale për viktimë që  
4 mund të akordohet nga Programi për Kompensimin e Viktimave të  
5 krimeve që është më e ulët se shuma e akorduar në Urdhrin për  
6 Zhdëmtim.

7 Tani do flas për një tjetër mjet ekzekutimi që ka të bëjë  
8 me krijimin e një mekanizmi të ri zhdëmtimi në Kosovë.

9 Trupi Gjykues mban parasysh faktin se Kosova ende nuk ka  
10 marrë asnjë hap konkret për t'u përgatitur lidhur me nevojën  
11 për sigurimin e zhdëmtimit të viktimave të krimeve të  
12 përfshira në juridiksionin e Dhomave të Specializuara. Trupi  
13 Gjykues gjithashtu vëren se, nga ana tjetër, Kosova parashikoi  
14 nevojën për të mbështetur financiarisht Mbrojtjen e të  
15 dyshuarve dhe të akuzuarve para Dhomave të Specializuara, dhe  
16 vazhdon të ofrojë mbështetje të konsiderueshme.

17 Gjithashtu Trupi Gjykues vëren se legjislacioni i Kosovës  
18 që trajton dëmin dhe lëndimet e pësuar në kontekstin e luftës  
19 së armatosur në Kosovë në vitet 1998, 1999, i referohet  
20 ekskluzivisht viktimave të shkaktuara prej forcave të armikut,  
21 domethënë, forcave serbe dhe jo të gjitha viktimave të  
22 konfliktit të armatosur në Kosovë. Sipas Trupit Gjykues, këto  
23 ligje krijojnë diskriminim midis viktimave të këtij konflikti  
24 të armatosur.

25 Trupi Gjykues bën të ditur se ndonëse nuk ka kompetenca

1 të urdhërojë Kosovën të paguajë kompensimin që u është  
2 akorduar tetë viktimave, ai megjithatë e vlerëson të  
3 rëndësishme që - edhe një herë - t'i kujtojë Kosovës detyrimet  
4 e saj në lidhje me të drejtën e viktimave përmjet efektiv  
5 juridik të mishëruar në nenin 54 të Kushtetutës dhe në  
6 marrëveshjet ndërkombëtare. Kjo e drejtë përfshin detyrën për  
7 të garantuar që ky mjet juridik të jetë i zbatueshëm.

8 Rrjedhimisht, Trupi Gjykses përsëri i bën thirrje Kosovës  
9 të miratojë ligjet e nevojshme dhe të krijojë një mekanizëm  
10 zhdëmtues për qëllimin e kompensimit të plotë të viktimave të  
11 krimeve të përfshira në juridiksionin e Dhomave të  
12 Specializuara.

13 Sipas Trupit Gjykses, kjo do të garantonte, brenda  
14 sistemit ligjor të Kosovës, trajtim të barabartë midis  
15 viktimave dhe të dyshuarve ose të akuzuarve në proceset e  
16 Dhomave të Specializuara. Trupi Gjykses gjithashtu thekson se  
17 në krijimin e këtij mekanizmi zhdëmtues duhet shqyrtuar  
18 mundësia e financimit të tij përmes buxhetit të Kosovës. Trupi  
19 Gjykses vëren se edhe Mbrojtja e të dyshuarve dhe të akuzuarve  
20 para Dhomave të Specializuara financohet përmes atij buxheti.  
21 Sipas Trupit Gjykses, ky përdorim i barabartë i buxhetit të  
22 Kosovës do të promovonte mandatin e Dhomave të Specializuara  
23 sipas nenit 1(2) të ligjit të mbështetur nga Kosova dhe  
24 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian së bashku me shtetet e  
25 tjera kontribuuese që mbështesin financiarisht punën e DHSK-

1 së.

2 Në këtë aspekt, Trupi Gjykses vë në dukje se Komisioni  
3 Evropian ka theksuar kohët e fundit se, dhe këtu citoj:

4 "Kosova ka krijuar një fond që u jep ndihmë juridike të  
5 akuzuarve në Dhomat e Specializuara të Kosovës, si dhe  
6 mbështetje financiare familjarëve të tyre, pa asnjë dëshmi për  
7 nevoja financiare. Por, deri më tani, nuk është ofruar asnjë  
8 mbështetje financiare për viktimat për të cilat Dhomat e  
9 Specializuara të Kosovës kanë konstatuar se kanë vuajtur si  
10 pasojë e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit.

11 Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë lëshuar Urdhrin e parë  
12 për Zhdëmtimin e viktimave. Rrjedhimisht nuk është e qartë se  
13 si do të kompensohen viktimat në mungesë të fondeve nga të  
14 akuzuarit apo të një fondi të Kosovës për këtë qëllim. Është  
15 thelbësore që Kosova ta trajtojë këtë pabarazi në trajtim."

16 Për rrjedhojë, Trupi Gjykses thekson që viktimat e krimit  
17 që janë nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara nuk mund  
18 të zbatojnë të drejtën për zhdëmtim dhe kjo e drejtë do ishte  
19 e pakuptimtë.

20 Në këtë aspekt, Trupi Gjykses rikujton se në kontekstin e  
21 procesit Mustafa, rekomandoi krijimin me nismën e Dhomave të  
22 Specializuara dhe nën administrimin e Administratores të një  
23 fondi për viktimat e krimeve të përfshira në juridiksionin e  
24 Dhomave të Specializuara. Ky fond duhet të mbështetet në radhë  
25 të parë nga Kosova, duke pasur parasysh detyrimet e saj ndaj

1 viktimave të përshkruara më lart, si edhe nga shtetet dhe  
2 donatorë të tjerë që dëshirojnë të mbështesin viktimat.

3 Trupi Gjykses gjithashtu thekson se, aktualisht, ekziston  
4 një mundësi që Dhomat e Specializuara të marrin donacione  
5 vullnetare dhe të pakushtëzuara si kontribute për pagimin e  
6 zhdëmtimeve që u akordohen viktimave me një urdhër  
7 përfundimtar për zhdëmtim të lëshuar nga Dhomat e  
8 Specializuara. Adresa e postës elektronike e caktuar  
9 posaçërisht për kërkim informacioni në lidhje me këto  
10 kontribute vullnetare jepet në tekstin e Urdhrit për Zhdëmtim.

11 Megjithatë, Trupi Gjykses thekson se ekzistenca e kësaj  
12 mundësie përmes Dhomave të Specializuara nuk e liron në asnjë  
13 mënyrë z. Shala nga detyrimi për të kompensuar tetë viktimat  
14 në përputhje me këtë Urdhër për Zhdëmtim, dhe Kosovën nga  
15 përmbushja e detyrimeve të veta ndaj viktimave brenda një kohe  
16 të arsyeshme përmes krijimit të një mekanizmi për zhdëmtim,  
17 ashtu sikurse e përmenda dhe më lart.

18 Rrjedhimisht, për arsyet e përmbledhura më lart, Trupi  
19 Gjykses:

20 Lëshon urdhrin për Zhdëmtim kundër z. Shala.

21 Konstaton se Viktimat 01, 02, 03, 04, 05, 06, 07 dhe 08  
22 kanë vërtetuar në bazë të standardit të vërtetimit të tërësisë  
23 së gjasave se janë viktimat të krimeve për të cilat z. Shala u  
24 shpall fajtor.

25 Vendos t'u akordojë zhdëmtim viktimave të lartpërmendura.

1 Akordon zhdëmtim individual në formën e kompensimit  
2 përkatësisht, për dëmin fizik, mendor dhe material të pësuar  
3 prej tij për Viktimën 01 dhe zhdëmtim individual dhe të  
4 përbashkët në formën e kompensimit për Viktimat 02, 03, 04,  
5 05, 06, 07, dhe 08 për, përkatësisht, dëmin mendor dhe  
6 material të pasuar prej tyre.

7 Cakton shumë e zhdëmtimit për të cilin z. Shala është  
8 përgjegjës në 208,000 euro. Urdhëron z. Shala të paguajë, si  
9 kompensim për dëmin e shkaktuar.

10 100,000 euro Viktimës 01 për dëm fizik, mendor dhe  
11 material,

12 8000 euro për person për Viktimat 02, 04, 05, 06, 07, dhe  
13 08 për dëm mendor,

14 10,000 euro Viktimës 03 për dëm mendor dhe

15 50,000 euro gjithsej Viktimave 02, 03, 04, 05, 06, 07 dhe  
16 08 për dëm material.

17 Konstaton se z. Shala i mungojnë mjetet financiare në  
18 këtë fazë për përmbushjen e Urdhrit për Zhdëmtim.

19 Urdhëron Administratoren të marrë masat e nevojshme për  
20 vënien në jetë të Urdhrit për Zhdëmtim.

21 Fton Kryetarin e Dhomave të Specializuara të caktojë një  
22 Gjykatës të Vetëm për monitorimin dhe mbikëqyrjen e vënies në  
23 jetë dhe zbatimit të këtij Urdhri për Zhdëmtim.

24 Fton Kosovën të kërkojë një mekanizëm të ri zhdëmtues për  
25 viktimat e krimeve të përfshira në juridiksionin e Dhomave të

1 Specializuara për të korrigjuar pabarazitë aktuale në sistemin  
2 ligjor të Kosovës sikurse përshkruhet në këtë Urdhër për  
3 Zhdëmtim.

4 Dhe urdhëron Administratoren t'ia përcjellë këtë Urdhër  
5 për zhdëmtim në versionin e redaktuar publik të tij Qeverisë  
6 së Kosovës.

7 Këtu përfundon përmbledhja e Urdhrit për Zhdëmtim.

8 Zyra Administrative tani do t'i japë një version të  
9 Urdhrit për Zhdëmtim në versionin elektronik, ndërkohë që z.  
10 Shala do të marrë një kopje të certifikuar të këtij teksti në  
11 anglisht. Ndërkohë versioni në shqip do t'i jepet z. Shala  
12 sapo ai të jetë gati.

13 Urdhri për Zhdëmtim i ditës së sotme mund të apelohet në  
14 pajtim me Ligjin dhe Rregulloren e Procedura të Dhomave të  
15 Specializuara.

16 Trupi Gjykses falënderon palët për pjesëmarrjen dhe Zyrën  
17 Administrative dhe njësitë e ndryshme të Zyrës Administrative  
18 për ndihmën e vazhdueshme që ata kanë dhënë gjatë gjithë këtij  
19 procesi gjyqësor.

20 Trupi Gjykses po ashtu i përcjell falënderimet publikut  
21 në galerinë publike që na ndoqën në dhënin e këtij Urdhri për  
22 Zhdëmtim dhe personat të cilët na kanë ndjekur në distancë nga  
23 Kosova ose gjetkë.

24 Trupi Gjykses përfundon këtu.

25 --- Seanca mbyllet n orën 11.42